

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A.B., L. B., A. B. dhe J. B., të gjithë nga ..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Sh. A., avokat nga ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “K. e R.” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paraqitur nga paditësit dhe revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3053/2014 datë 10.1.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me 8.5.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Pjesërisht pranohet revizioni i paditësve A. B. e L. B. dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3053/2014 datë 10.1.2019, në pjesën I të dispozitivit, ashtu që e paditura K. e S., ‘’K. e R.’’, me seli në Prishtinë, detyrohet që paditësve A.B., e L.B., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e djalit të tyre t’iu paguajë shumën secilit prej nga 8.000 €, kurse mbi këto shuma kërkesëpadia e paditësve refuzohet si e pabazuar, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi i kundërshtuar vërtetohet.

Refuzohet si i pabazuar **revizioni i të paditurës** paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3053/2014 datë 10.1.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3053/2014 datë 10.1.2019, është aprovuar pjesërisht ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Mitrovicë - Dega në Vushtrri, C.nr.339/2014 të datës 2.7.2014, në pjesën II të dispozitivit, ashtu që në vend të shumës së gjykuar prej 40.098 € është gjykuar shuma prej 25.098 €, ndërsa në vend të kamatës së gjykuar prej 3,5 % kamata është gjykuar në lartësi të cilën e aplikojnë bankat komerciale në mjetet e deponuara më tepër se një vit pa destinim të caktuar. Në të njëjtën pjesë të dispozitivit janë ndryshuar veç e veç shumat e gjykuar dhe atë në mënyrë si vijon: në emër të

kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore, për shkak të vdekjes së djalit F. B., babai A. B. në vend të shumës së gjykuar prej 11.000 €, i është gjykuar shuma prej 7000 €; nënës L. B., në vend të shumës së gjykuar prej 10.000 €, i është gjykuar shuma prej 7.000 €; ndërsa motrës A. B., dhe vëllait J. B., në vend të shumës së gjykuar prej nga 8000 €, janë gjykuar shumat secilit prej nga 4000 €. Në pjesën tjetër ankesa e të paditurës është refuzuar, ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësit kanë paraqitur revizion për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që paditësve të ju gjykoi shumat më të larta për kompensimin e dëmit, ndërsa e paditura revizionin e ka paraqitur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësve, me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i paditësve është pjesërisht i bazuar.

Revizioni i të paditurës është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme ka gjetur se më datë 10.9.2012, në rrugën magjistrale Prishtinë - Mitrovicë ka ndodhur fatkeqësia e komunikacionit në të cilën në cilësinë e këmbësorit ka vdekur tani i ndjeri F. B., Paditësit janë babai, nëna, vëllai dhe motra e tani të ndjerit, të cilët kanë jetuar në bashkësinë familjare me tani të ndjerin, ndërsa me vdekjen e tij paditësit kanë pësuar dhimbje shpirtërore për humbjen e djalit gjegjësisht vëllait të tyre, janë krijuar shpenzime materiale për varrimin e tij dhe ngritjen e lapidarit, andaj për këto arsye me padi kanë kërkuar që të detyrohet e paditura t'ua paguajë shumat e cekura si në kërkesëpadi.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësit kanë pësuar dëm jo material dhe material dhe duke aplikuar dispozitat ligjore nga neni 185, 200 dhe 201 të LMD -ës, me zbatimin e nenit 323 të LPK, ka caktuar shumat e cekura si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore pjesërisht ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për dëmin jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të humbjes së anëtarit të ngushtë të familjes, ashtu që ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike por të drejtën materiale e ka zbatuar në mënyrë të gabuar, ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se paditësve u janë shkaktuar dhimbje shpirtërore, për shkak të vdekjes së djalit gjegjësisht vëllait të tyre F. B., i cili derisa ka qen duke qarkulluar në shiritin e djathtë të rrugës në urë është goditur nga automjeti i markës ..., me targë të regjistrimit ..., i siguruar te e paditura, të cilin e ka drejtuar B. K..

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit A. dhe L. B., nuk janë adekuate, nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit të tyre, duke pasur parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, siç është paraparë me nenin 200 par. 1 e 2 të LMD, prandaj, kjo Gjykatë duke pranuar pjesërisht revizionin e paditësve e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që në emër të dëmit jo material, në formë të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e djalit të tyre paditësve A. dhe L. B., u caktoi shumën secilit prej nga 8.000 €, duke marrë për bazë faktin se gjykatat e instancës më të ulët kanë vërtetuar se deri te fatkeqësia e komunikacionit ka ardhur me lëshimet ekskluzive të ngasësit të automjetit i siguruar te e paditura.

Nisur nga kjo, dhe duke pasur parasysh rëndësinë e së mirës së cenuar, qëllimin e përmendur për shpërblimin në të holla, kjo Gjykatë konsideron se, me ndihmën e shumave të caktuara, paditësit do të mund të përjetonin një satisfaksion të konsiderueshëm për dhimbjet shpirtërore të shkaktuara me rastin e vdekjes së fëmijës së tyre, gjegjësisht vëllait së tyre.

Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet me të cilin të dëmtuarit, duke i kënaqur nevojat që nuk do të mund t'i plotësonin, iu bënë më të lehtë jetën e tyre, duke bërë atë më të durueshëm, zbutë dhimbjet shpirtërore të cilat i përjetojnë.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e paditësve sipas të cilave me rastin e zvogëlimit të shumës së kompensimit të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, nga ana e gjykatës së shkallës së dytë gabimisht është zbatuar e drejta materiale të cilin pretendim sa i përket paditësve A. dhe L. B., kjo Gjykatë e vlerësoi si të bazuar, ngase të njëjtit kanë pësuar dhimbje posaçërisht të rënda shpirtërore për humbjen e djalit të tyre, i moshës 17 vjeçare, e sidomos faktin që babai si person zyrtar – polic, me rastin e daljes në vendin e ngjarjes është njoftuar se i ndjeri në fjalë është djali i tij dhe ka parë kufomën në vendin e ngjarjes. Andaj Gjykata Supreme e Kosovës duke marrë për bazë rrethanat e rastit, kriteret e përcaktuara në nenin 200 par.2 të LMD –ës, shkallën e zhvillimit ekonomik dhe standardin jetësor të qytetarëve në Kosovë, vlerësoi se shumtë e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për paditësit A. e L. B., në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen tragjike të birit të tyre, nuk janë adekuate, andaj vlerësoi se në këtë pjesë aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të zbatimit të gabuar të drejtës materiale për të cilin shkak u deshtë që në këtë pjesë aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe paditësve A. e L. B., tu gjykohen shumtë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Ndërsa, për paditësit A. dhe J. B., shumtë e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë adekuate dhe mund të arrihet qëllimi i zbutjes së dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e vëllait.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se revizioni i të paditurës është i pabazuar, ngase, shumtë e caktuar është reale nga fakti se prindërve u janë shkaktuar dhimbje posaçërisht të rënda për humbjen e birit të tyre, e gjithashtu edhe motra e vëllai kanë pësuar dhimbje shpirtërore për humbjen e vëllait të tyre.

Pretendimet e revizionit të paditurës se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 par 2 pika (n) të LPK –ës, gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe në aktgjykim janë dhënë arsye për faktet vendimtare. Në revizion nuk ceket asnjë pretendim konkret i cili do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, ndërsa pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë për bazë raportin e policisë në të cilin është konstatuar se tani i

ndjeri ka përgjegjësi për 30 % në shkaktimin e fatkeqësisë, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson si të pabazuar, ngase, me ekspertizën e komunikacionit është vërtetuar fakti se aksidenti rrugor ka ndodhur nga lëshimet e drejtuesit të automjetit BMW, i cili gjatë lëvizjes me automjet, në momentin e paraqitjes së rrezikut, nuk i ka kushtuar kujdese të duhur këmbësorit, nuk ka marrë veprimet e nevojshme për të evituar aksidentin, e ka nënvlerësuar situatën e krijuar në rrugë, nuk ka reaguar me kohë dhe në mënyrën më të mirë, nuk ka ndërmarrë veprim frenimi për të ndaluar automjetin, por është munduar që me anë të manovrimeve me timon të evitoi aksidentin dhe lëshimet kanë ekzistuar vetëm në anën e drejtuesit të automjetit të siguar te e paditura.

Në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të zbatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, andaj pretendimet e revizionit në këtë drejtim Gjykata Supreme nuk i shqyrtoi.

Pretendimet e të paditurës të cekura në revizion lidhur me dëmi material në emër të shpenzimeve të varrimit dhe për ngritjen e lapidarit, kjo Gjykatë i vlerësoi si të pabazuara, ngase gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur në bazë të provave të cilat kanë qenë prezentë në shkresat e lëndës.

Pretendimet e të paditurës të cekura në revizion lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, ngase në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye konkrete për secilin shpenzim të krijuar gjatë procedurës dhe duke zbatuar nenin 452 par. 2 të LPK, në mënyrë të drejtë ka vendosur kur ka obliguar të paditurën që paditësve tu paguhet edhe shuma prej 2.553 €, për shpenzime procedurale.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 224 par. 1 dhe 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 8.5.2019, Rev.nr.151/2019

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku

